- 461.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Formulare nr.89 (1832), në ngarkim të M.M.; dosja daton në vitet 1975-1986, me 41 (dyzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 462.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Formulare nr.90 (1966), në ngarkim të E. Sh; dosja daton në vitet 1978-1988, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 463.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Formulare nr.91 (1997), në ngarkim të Q.B.; dosja daton në vitet 1972-1986, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
- 464.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Formulare nr.92 (2426), në ngarkim të Ll. P.; dosja daton në vitet 1963-1988, me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 465.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Formulare nr.93 (2072), në ngarkim të K.L.; dosja daton në vitet 1979-1986, me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 466.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Formulare nr.94 (2036), në ngarkim të I.S.; dosja daton në vitet 1979-1986, me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 467.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Formulare nr.95 (2069), në ngarkim të L.P.; dosja daton në vitet 1962-1985, me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 468.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Formulare nr.96 (2311), në ngarkim të M.L.; dosja daton në vitet 1961-1989, me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 469.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Formulare nr.97 (2412), në ngarkim të E.B.; dosja daton në vitet 1976-1987, me 236 (dyqind e tridhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 470.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Formulare nr.98 (2515), në ngarkim të G. Th.; dosja daton në vitet 1949-1987, me 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 471.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Formulare nr.99 (3088), në ngarkim të Ç.J.; dosja daton në vitet 1961-1990, me 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 472.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Agjenturore nr.100 (31), me pseudonimin "Bloza"; dosja daton në vitet 1960-1990, me 159 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 473.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Agjenturore nr.101 (126), me pseudonimin "Krokodili"; dosja daton në vitet 1975-1977, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 474.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Agjenturore nr.102 (137), me pseudonimin "Nëpërka"; dosja daton në vitet 1975-1988, me 3 vëllime, me 54 (pesëdhjetë e katër) 29 (njëzet e nëntë) dhe 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 475.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje Agjenturore nr.103 (183), me pseudonimin "Mali"; me 2 vëllime; dosja daton në vitin 1981, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) dhe 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 476.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje fashikull nr.104 (324), me pseudonimin "Mercenarët"; dosja daton në vitet 1986-1988, me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".

- 477.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje agenturore nr.52, me pseudonimin "Epidemia"; kutia 5 me 6 vëllime; dosja daton në vitet 1987-1991, me 9 (nëntë), 253 (dyqind e pesëdhjetë e tre), 250 (dyqind e pesëdhjetë), 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë), 210 (dyqind e dhjetë), 340 (treqind e dyzet) fletë; kutia 6 me 5 vëllime, me 303 (treqind e tre), 367 (treqind e gjashtëdhjetë e shtatë), 227 (dyqind e njëzet e shtatë), 291 (dyqind e nëntëdhjetë e një), 186 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë); kutia 7 me 1 vëllim, me 287 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 478.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje agenturore nr.64 (323), me pseudonimin "Zvarranikët"; dosja daton në vitin 1986, me 287 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
- 479.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje e drejtimit të kundërzbulimit nr.65 (1); dosja daton në vitin 1972-1984, me 2 vëllime, me 220 (dyqind e njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 480.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje drejtimi për Agjitacionin dhe Propagandën Armiqësore nr.66; dosja daton në vitet 1973-1989, me 223 (dyqind e njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 481.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Dosje nr.67 "Raporte të bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Ndërmarrjes Shpim Kërkimit të Naftës; dosja daton në vitet 1972-1990, me 229 (dyqind e njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
- 482.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, Dosje personale dhe pune nr. 1903, me pseudonimin "Alpinisti", me tre vëllime, me 223 (dyqind e njëzet e tre), 120 (njëqind e njëzet) dhe 32 (tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 483.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, Dosje pune nr. 1178, 1178/1 dhe 1178/2, me pseudonimin "Qytetërimi", me tre vëllime, me 273 (dyqind e shtatëdhjetë e tre), 167 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) dhe 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 484.** Fondi Dega IV, Dosje pune nr. 24278/1 në ngarkim të A.Q., me pseudonimin 'Akili', me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 485.** Fondi Dega IV, Kartelë model.2 me nr.2226, me pseudonimin "Guri i Shqipës", me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
- 486.** Fondi Dega IV, Kartelë model.2 me nr.1777 me pseudonimin "Tigri", me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
- 487.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, Dosje përpunimi nr.1609, në ngarkim të Z.K., me katër vëllime, me 788 (shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) fletë dhe 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë në xhep. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 488.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Durrës, Dosje personale nr. 7294, me pseudonimin "Tigri", në ngarkim të A.G., me 41 (dyzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 489.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, Dosje përpunimi nr.2020, në ngarkim të Th. F., me dy vëllime, me 411 (katërqind e njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 490.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, Dosje pune nr.1133 dhe 1133/1, në ngarkim të J. Gj., me pseudonimin "Spitali i Glinës", me dy vëllime me 372 (treqind e shtatëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 491.** Fondi Dega IV (fondi rezervë), Dosje me implikime nr. 13, në ngarkim të Ll. B., me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 492.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje pune personale nr. 8622, me pseudonimin "Semani" në ngarkim të Ll. B, me 2 vëllime, me 38 (tridhjetë e tetë) dhe 142 (njëqind e dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 493.** Fondi Nr.4, Dosje nr.83, viti 1991, "Vlerësime të Komisionit të Ekspertizës për asgjësim dokumentesh", me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
- 494.** Fondi Nr.4, Dosje nr.142, viti 1979 "Dekret i Presidiumit për internimin dhe dëbimin, si masë administrative", me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".

- 495.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Durrës, Dosje personale pune nr. 868, vitet 1952-1973, në ngarkim të N.H., me 438 (katërqind e tridhjetë e tetë) dhe 169 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 496.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Durrës, Dosje Hetimore-Gjyqësore nr. 16, viti 1985, në ngarkim të K.T., me 46 (dyzet e gjashtë) dhe 130 (njëqind e tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 497.** Fondi i të Arratisurve, Dosje nr.111, në ngarkim të Y.K., vitet 1954-1988, me 242 (dyqind e dyzet e dy) fletë; dosja daton në vitet 1950-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 498.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, Dosje personale dhe pune nr. 5596, me pseudonimin "Frigoriferi", vitet 1976-1979; me 30 (tridhjetë) dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 499.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje pune nr. 201, me pseudonimin "Dajti", vitet 1982-1984; me 226 (dyqind e njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 500.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kavajë, Dosje personale nr. 6697, me pseudonimin "Peneli", vitet 1979-1981, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 501.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kukës, Dosje personale dhe pune nr. 1487, me pseudonimin "Rinia", vitet 1972-1989, me 35 (tridhjetë e pesë) dhe 122 (njëqind e njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 502.** Fondi Nr.4, Dosje nr.83, viti 1991, "Vlerësime të Komisionit të Ekspertizës për asgjësim dokumentesh", me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
- 503.** Fondi Nr.4, Dosje nr.79, viti 1991, "Urdhër i Ministrit të Punëve të Brendshme, për disa probleme të evidencës operative", me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
- 504.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje formulare nr. 8300, në ngarkim të A.T., me 21 (njëzet e një) fletë; dosja daton në vitet 1980-1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 505.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje përpunimi nr.12041, në ngarkim të A.A., me dy vëllime, me 13 (trembëdhjetë) dhe 11 (njëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1987-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 506.** Fondi Operativ, Dosje agjenturale nr. 588, me pseudonimin "Korabi", dosja daton në vitet vitet 1957-1962, me 5 vëllime me 148 (njëqind e dyzet e tetë) 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë) 190 (njëqind e nëntëdhjetë) 108 (njëqind e tetë) dhe 88 (tetëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 507.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Dibër, Dosje përpunimi nr.1116, në ngarkim të M.K, me 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër) fletë; dosja daton në vitet 1951-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 508.** Fondi Dega IV, Dosje pune nr. 29 në ngarkim të F.H, dosja daton në vitet 1976-1977, me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
- 509.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kavajë, Dosje formulare nr. 1825, me 21 (njëzet e një) fletë; dosja daton në vitet 1971-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 510.** Fondi Kosova, Dosje fashikull nr. 873, në ngarkim të R.A, me 41 (dyzet e një) fletë; dosja daton në vitet 1953-1954. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 511.** Fondi Operativ, Dosje formulare nr. (4454)1077, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitet 1982-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 512.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje formulare nr.8889, në ngarkim të B.K., me 99 (nëntëdhjetë e nëntë) fletë; dosja daton në vitet 1982-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
- 513.** Fondi Drejtoria II, Dosje nënobjekti Universiteti i Prishtinës nr. 4, me 5 vëllime, me 73 (shtatëdhjetë e tre), 112 (njëqind e dymbëdhjetë), 181 (njëqind e tetëdhjetë e një), 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) dhe 434 (katërqind e tridhjetë e katër) fletë; dosja daton në vitet 1972-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".

- 514.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, Dosje përpunimi nr.4708, në ngarkim të Q.S., me 89 (tetëdhjetë e nëntë) fletë; dosja daton në vitet 1967-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
- 515.** Fondi Kosova, Dosje nr.10768, në ngarkim të M.P., me 14 (katërbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1980-1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
- 516.** Fondi Kosova, Dosje nr.11579, në ngarkim të F.H., me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1979-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
- 517.** Fondi Kosova, Dosje nr.195, në ngarkim të H.K., me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë; dosja daton në vitet 1971-1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

KRYETARI I KDZH-së

Dr. Gentiana Sula

Vendim nr. 6, datë 02.06.2023 (i shkurtuar)

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, *“Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, i ndryshuar, të Kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, *“Për informacionin e klasifikuar”*, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 *“Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”*”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër, Urdhrin nr. 21, datë 06. 02. 2023, të Kryetarit të Autoritetit *“Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”*, i ndryshuar, me Urdhrin nr. 56, datë 23.03.2023 *“Për një ndryshim në Urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023 “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me Vendimin nr. 6, datë 02.06.2023, si më poshtë:*

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

- 1.** Fondi Operativ, Dosje formulare nr. 3125, në ngarkim të V.S., dosja daton në vitet 1979-1984, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
- 2.** Fondi Operativ, Dosje agjenturiale-operative nr.2646, me pseudonimin “Litari”, dosja daton në vitet 1959-1965, me 152 (njëqind e pesëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
- 3.** Fondi Të Arratisur, Dosje formulare nr.1718, në ngarkim të M.P., me 12 (dymbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1955-1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
- 4.** Fondi Operativ, Dosje formulare nr. 268, në ngarkim të P.B., me pseudonimin “Bufi”, dosja daton në vitet 1959-1981, me 2 vëllime, me 379 (treqind e shtatëdhjetë e nëntë) dhe 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
- 5.** Fondi Drejtoria II, Dosje Fashikull nr. 145, në ngarkim të I.K, me pseudonimin “Ciklopi”, dosja daton në vitet 1977-1990, me 122 (njëqind e njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
- 6.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lezhë, Dosje përpunimi nr. 1615, në ngarkim të P.M., dosja daton në vitet 1978-1989, me 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
- 7.** Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 152, në ngarkim të L.G, dosja daton në vitet 1973-1987, me 409 (katërqind e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
- 8.** Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje formulare nr. 8057, në ngarkim të M. Gj., dosja daton në vitet 1959-1984, me 107 (njëqind e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

9. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje formulare nr. 8037, në ngarkim të A. K., dosja daton në vitet 1980-1984, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
10. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kukës, Dosje personale dhe pune nr. 233, në ngarkim të N.S., me pseudonimin "Zambaku", dosja daton në vitet 1958-1990, me 3 volume me 50 (pesëdhjetë), 44 (dyzet e katër) dhe 324 (treqind e njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
11. Fondi Operativ, Dosje formulare nr. 5989, në ngarkim të G. C., dosja daton në vitin 1986, me 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
12. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kukës, Dosje personale dhe pune nr. 2851, në ngarkim të R.L., me pseudonimin "Trimi", dosja daton në vitet 1976-1988, me 39 (tridhjetë e nëntë) dhe 136 (njëqind e tridhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
13. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kukës, Dosje personale dhe pune nr. 1209, në ngarkim të H.M., me pseudonimin "Vigjilenti", dosja daton në vitet 1970-1988, me 43 (dyzet e tre) dhe 421 (katërqind e njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
14. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kukës, Dosje personale dhe pune nr. 4644, në ngarkim të Sh. C., me pseudonimin "Letra", dosja daton në vitet 1968-1990, me 61 (gjashtëdhjetë e një) dhe 129 (njëqind e njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
15. Fondi i Veçantë, Dosje nr. 6279, në ngarkim të M.D., me pseudonimin "Graniti", dosja daton në vitet 1982-1988, me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
16. Fondi Dega IV, Dosje pune nr. 20839, me pseudonimin "Dajti", dosja daton në vitet 1976-1980, me 2 vëllime, 742 (shtatëqind e dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
17. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje personale nr. 201, në ngarkim të A.Q., me pseudonimin "Dajti", dosja daton në vitet 1976-1991, me 148 (njëqind e dyzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
18. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje pune nr. 201, me pseudonimin "Dajti", dosja daton në vitet 1984-1989, me 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) dhe 218 (dyqind e tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
19. Fondi Operativ, Dosje nr. 2380, në ngarkim të S. Sh., dosja daton në vitet 1974-1980, me 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
20. Fondi Operativ, Dosje pune dhe personale nr. 798, me pseudonimin "Gjallica", dosja daton në vitet 1975-1976, me 205 (dyqind e pesë) 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) dhe 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
21. Fondi i Veçantë, Dosje personale dhe pune nr. 3013, në ngarkim të Sh. R., dosja daton në vitet 1983-1989, me 2 volume me 196 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) dhe 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
22. Fondi Drejtoria II, Dosje personale dhe pune nr. 1585, në ngarkim të S.R., me pseudonimin "Historiani", dosja daton në vitet 1970-1990, me 2 volume me 325 (treqind e njëzet e pesë) dhe 235 (dyqind e tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
23. Fondi i Veçantë, Dosje personale dhe pune nr. 1735, në ngarkim të Z.C., me pseudonimin "Bilbili", dosja daton në vitet 1978-1990, me 3 volume me 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) fletë + 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë në zarf, 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë dhe 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
24. Fondi Të Arratisur, Dosje nr. 2445, në ngarkim të P.P., dosja daton në vitet 1950-1987, me 148 (njëqind e dyzet e tetë) fletë dhe 3(tre) fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
25. Fondi Operativ, Dosje agenturale nr. 4266, në ngarkim të P.P., dosja daton në vitin 1954, me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
26. Fondi Drejtoria II, Dosje personale dhe pune nr. 5018, në ngarkim të E.B., dosja daton në vitet 1984-1988, me 2 volume me 169 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë dhe 70 (shtatëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".

27. Fondi Drejtoria II, Dosje personale dhe pune nr. 6001, dosja daton në vitet 1983-1988, me pseudonimin "Horizonti" me 4 volume, me 256 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) fletë, 232 (dyqind e tridhjetë e dy) fletë, 269 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë dhe 235 (dyqind e tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".

KRYETARE E KDZH-së

Dr. Gentiana Sula

Vendim nr. 7, datë 05.06.2023 (i shkurtuar)

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, të Kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhër, Urdhrin nr. 21, datë 06. 02. 2023, të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", i ndryshuar, me Urdhrin nr. 56, datë 23.03.2023 "Për një ndryshim në Urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023 "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me **Vendimin nr. 7, datë 05.06.2023**, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi Operativ, Dosje formulare nr. 2798, në ngarkim të P.K., dosja daton në vitet 1947-1982, me 122 (njëqind e njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
2. Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Libri i dorëzimit të dokumenteve të vëzhgimit nr. 8. Regjistri daton në vitet 1987 – 1991, me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret".

KRYETARE E KDZH-së

Dr. Gentiana Sula



KUJTESA

**DHE EDUKIMI
QYTETAR**

SPAÇI NË ARKIVA - 50 VJET NGA REVOLTA

Më datë 4 maj, Autoriteti për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit mbajti aktivitetin “Spaçi në arkiva -50 vjet nga Revolta”, me dokumente nga arkiva e ish-Sigurimit të Shtetit për kampin e punës së detyruar në Spaç, revoltën, vendimet me vdekje dhe ridënimet.

Aktiviteti synoi nxitjen e analizës dhe debatit profesional juridik mbi zbatimin e ligjeve të kohës parë nga perspektiva e shkëlqes së të drejtave të njeriut. Aktiviteti gjeti mbështetje nga partnerët akademikë të Autoritetit, Shkolla e Magjistraturës, Universiteti Evropian i Tiranës dhe Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës.



AUTORITETI NË PELEGRINAZHIN “GJURMË QËNDRERE DHE SOLIDARITETI” NË KUJTIM TË 50-VJETORIT TË REVOLTËS SË SPAÇIT

Mirditë, më 21.05.2023- Me rastin e organizimeve për përkujtimin e 50-vjetorit të Revoltës së Burgut të Spaçit, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit organizoi një pelegrinazh që nisi në kilometrin e fundit të rrugës, në hyrje të ish-Burgut të Spaçit dhe u përmbyll në ambientet e ish-burgut.



Pelegrinazhit iu bashkua SH.T. Z Bajram Begaj, President i Republikës së Shqipërisë, Arqipeshkivi i Dioqezës së Rrëshenit, Dom Gjergj Meta, përfaqësues të pushtetit lokal dhe të trupit diplomatik, ish-të përndjekur politikë dhe organizatat që veprojnë në fushën e kujtesës.

Gjatë rrugëtimit Autoriteti shpalosi instalacionin artistik “Gjurmë qëndrese dhe solidariteti”, me 10 silueta njerëzore, në shenjë kujtimi dhe përjetimi të dhimbjes, vuajtjes dhe qëndresës që kalonin çdo ditë gratë, fëmijët dhe familjarët e të dënuarve.

Kryetarja e Autoritetit Dr. Gentiana Sula, me këtë rast, tha: “Ata u qëndruan pranë familjarëve të tyre edhe në ditët me të errëta, pavarësisht stigmës, përjashtimit dhe kostove personale. Instalacioni synon njohje, nderim e vlerësim për humanizmin e tyre dhe reflektim, për një shoqëri më njerëzore.

Kjo është një ngjarje që bashkon njerëzit, për të nderuar ata që kanë humbur, që të gjejnë ngushëllim dhe mbështetje te njëri-tjetri, si dhe të zhvillojnë ndjenjën e solidaritetit, që na ndihmon të punojmë së bashku, për t'u rikuperuar dhe rindërtuar.”

Ky organizim i Autoritetit ishte pjesë e programit të ceremonisë që, Dioqeza Rëshen dhe Bashkia Mirditë mbajti në bashkëpunim me institucionet dhe organizata që angazhohen në fushën e kujtesës historike, me rastin e përkujtimin të revoltës së të burgosurve politikë të Spaçit, të 21 majit të vitit 1973.

Siluetat, përmbajtja e instalacionit:

Instalacioni “Gjurmë qëndrese dhe solidariteti” nën *hashtagun* #KurrëMëDiktaturë përmban tregimet e 10 njerëzve që kanë vuajtur në burgun e Spaçit, përfshi këtu dhe familjarët e tyre: gra, nëna dhe fëmijë, të cilët, po ashtu si të afërmit e tyre të burgosur, i bënë ballë padrejtësisë me vetëmohim e dinjitet njerëzor. Tregimet e tyre janë pjesë e dëshmime gojore që Autoriteti ka realizuar, ndërsa me kujdes, janë përzgjedhur disa dëshmi të publikuara në medie.

Ja çfarë lexojmë në silueta:

Iliaz Kaja, ish-i dënuar, me akuzën agjitacion e propagandë. Vuajti dënimin me 8 vite burg, në Spaç.



“Çanga e zgjimit binte në orën 5:00. Pas apelit, në orën 6:00, dilnim nga kampi dhe i ngjiteshim malit. Ecnim një orë e gjysmë, derisa mbërrinin në galeri. Aty përshëndeteshim me shprehjen ‘Mirë dalsh!’, se edhe mund të mos dilnim më gjallë”.

Napoleon Gumeni, ishte 10 vjeç, në prill të vitit 1970, kur iu arrestua babai, Izet Gumeni, dënuar me 25 vjet heqje lirie, me akuzën për bashkëpunim me bandat.

“Nuk harroj. Isha 14 vjeç. Bashkë me motrën e vogël, mbërritëm rreth orës dy, në Spaç. Polici nuk na lejoi ta takonim babanë atë ditë, pasi na tha që ishte në punë. Fjetëm pas një barake të komandës, të rrahur nga era e ftohtë e grykës së Spaçit”.



Menduhije Pojani, vajza e Njazi Bylykbashit, ish-i dënuar për agjitacion e propagandë. Vuajti dënimin në burgun e Spaçit.

“Pas dënimit të babait, mamaja duhet të rriste katër fëmijët. Punonte gjithë ditën në bujqësi, mbante dru në kurriz, për të na ngrohur e ushqyer”. Na ndihmonte edhe gjyshja, në moshë të thyer.

Rajmond Sejko, djali i madh i Teme Sejkos, i arrestuar dhe dënuar për agjitacion e propagandë, me 8 vjet burgim në Spaç.

“Pengu im është se... nuk munda të përcjell për në banesën e fundit, babain Teme, vëllain Sokol e të mirën nënën time, Shpresa. Ende nuk e dimë, ku u prehen eshtrat”.

Lirie Alibali, gruaja e Ylli Alibalit dhe kunata e Xhevat Alibalit, ish-të dënuar me akuzën, agjitacion e propagandë.

“Pas arrestimit të bashkëshortit, m’u mbyllën të gjitha dyert para fytyrës. Askush nuk donte të kishte të bënte me mua. Të afërmit, më thonin: "Erdhe sot, mos hajde përsëri! Njerëzit largoheshin dhe ndërronin rrugë, ngaqë nuk donin të më flisnin, pasi isha me njollë në biografi. Nuk mund ta ndaja, babain e vajzave të mia. Pranova fatin tim!”

Luke Syku, gruaja e Prel Sykut, i arrestuar dhe dënuar me 20 vite burg, me akuzën agjitacion dhe propagandë.

“Shkova ta takoja, me djalin e vogël. Prela e la 6-muajsh. I përmalluar, i lëvdon të voglit sandalet: Sa të bukura! Djali ia kishte marrë borxh një shoku, sa për takimin me babanë”.

Ioan Çeli, ishte 16 vjeç kur i arrestohet i ati, ushtarak i dënuar me akuzën, për agjitacion e propagandë. “Pas arrestimit të babait, motra e madhe, që ndiqte studimet në Fakultetin e Filozofisë, në Tiranë, u përjashtua nga shkolla. Kërkuan ta nxirrnin për demaskim, para shkollës”.



Ornela Vorpsi, vajza e Seit Vorpsit, dënuar me akuzën, për agjitacion e propagandë. Vuajti 8 vite burgim, pjesën dërrmuese në Spaç.

“Pata frikë ta takoja, pasi ai donte të më përqafonte, por unë isha një fëmijë që trembesha ta prekja këtë të huaj. Në takim, babai i dha nënës një qese ku kishte futur dhëmbët. Ata i ishin thyer nga torturat e mëdha”.

Leonard Bejko, ishte 5 vjeç kur iu pushkatua babai, Dervish Bejko, i dënuar në vitin 1971, me akuzën, tentativë për arratisje. Është një nga të dënuarit me vdekje, të Revoltës së Spaçit, që shpërtheu më 21 maj, të vitit 1973.

“Babanë e kam brengë. Kam shumë boshllëk, se u rrita pa të. Në Pogradec, i kam ngritur një varr në kujtim të tij. Kur e vizitoj, ndez një cigare. Po kujt t’ia ndez?! Nuk ka eshtra. Ia ndez tokës, mermerit të ftohtë”.

Ylber Merdani, ish-i dënuar me akuzën, agjitacion e propagandë. Vuajti dënimin, me rreth 10 vite burg, në Spaç.

“Një popull që ruan në memorien e tij të kaluarën, ka në dorë çelësin e burgut. Nuk burgoset dot më kurrë e nuk rikthehet më e kaluara, se nuk ka forcë në botë, të kthejë fatin që ka caktuar i madhi Zot, për secilin nga ne. Fluturoni me shqiponjat, qëndroni të ndershëm dhe mos u përzieri me sorrat e minjtë!”.



AKTIVITETET E AUTORITETIT NË PËRKUJTIM TË REVOLTËS SË SPAÇIT

Grupi i punës së Autoritetit, ngritur në përkujtim të 50-vjetorit të revoltës së burgut të Spaçit, ka punuar për të sjellë 50 intervista audio-vizuale me ish-të përndjekur politikë në këtë burg, si dhe fëmijët e tyre. Këto intervista, janë pjesë e botimit që do të dalë së shpjeti, në qarkullim.

Janë hartuar me tekste dhe video, për Platformën - “Të mësojmë për të shkuarën - burime arsimore të hapura 1944-1991”, një platformë që vjen në shërbim të mësuesve të historisë, me qëllim përcjelljen e ngjarjes te nxënësit e sistemit parauniversitar.



ORË MËSIMI NË PËRKUJTIM TË REVOLTËS SË SPAÇIT

Më datë 22 maj, ora e parë e mësimit në sistemin parauniversitar, do t'i kushtohet përkujtimit të kësaj ngjarjeje, si nevojë për ndërgjegjësimin e brezave mbi të shkuarën e vendit. Përfaqësues të Autoritetit, së bashku me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, do të jenë në shkollat e mesme të vendit, për të marrë pjesë në këtë orë mësimore.




Nëpërmjet bashkëpunimit mes AIDSSH-së dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Autoriteti zhvilloi edhe një konkurs mes nxënësve të shkollave artistike të vendit, për krijimin e një logoje kushtuar 50-vjetorit të Revoltës së Spaçit, me qëllim final edukimin e brezit të ri, rreth padrejtësive të së kaluarës dhe nevojës në rritje, për respekt ndaj viktimave. Bazuar në pëlqimet e marra, fitues është punimi i nxënësit Rodjon Zhuri, klasa XII, shkolla artistike “Ajet Xhindole” Berat. Kjo logo, po përdoret përgjatë vitit 2023, në komunikimin shkresor zyrtar të Autoritetit.



AIDSSH NIS HETIMIN ADMINISTRATIV PËR VERIFIKIMIN E VENDVARRIMEVE TË FSHEHTA DHE QARTËSIMIN E FATIT TË 44 TË ZHDUKURVE NË BURGUN E SPAÇIT

Tiranë, më 02.06.2023 - Autoriteti për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit vendosi sot, nisjen e procedurës së hetimit administrativ, për verifikimin mbi vendvarrimet e dyshuara, qartësimin e fatit të dyzetekatër të zhdukurve, bashkëpunimin me organet e pushtetit lokal për ruajtjen nga tjetërsimi, si dhe bashkëpunimin me institucionet ligjzbatuese, për rikuperimin e eshtrave të personave të vrarë ose të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit, në burgun e Spaçit.

Grupi i specialistëve të Autoritetit, në bashkëpunim me institucionet vendore punuan për mbledhjen e fakteve paraprake, dëshmime dhe të dhënave rreth burgut të Spaçit, me qëllim hedhjen dritë mbi pasojat që ka sjellë shfrytëzimi i punës dhe dhuna ndaj të dënuarve në Kampin e Punës së Detyruar-Spaç.



Autoriteti mori nismën e përkujtimit të 50-vjetorit të revoltës së të burgosurve në Spaç, duke e parë si të nevojshëm me këtë rast, hetimin e thelluar mbi ngjarjen, arsyet që sollën zhvillimin dhe pasojat.

Nisur nga analiza e dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit dhe dokumenteve të tjera zyrtare mbi punën e detyruar, impaktin në ekonominë e vendit, dëshmitë gojore autentike të ish-të burgosurve politikë në këtë kamp, si dhe nga komunikimi me institucione lokale, Autoriteti ndërtoi narrativën mbi ngjarjen dhe historinë e

burgut-kamp të Spaçit, ku mes të tjerash lindi nevoja e verifikimit të dyshimeve të raportuara për vendvarrimet e fshehta dhe qartësimin e fatit të personave që kanë humbur jetën në këtë burg, si rezultat i ekzekutimeve, vrasjeve, apo edhe vdekjeve të të burgosurve gjatë vuajtjes së dënimit.

Nga kërkimet e bëra në dokumentet që gjenden në Autoritet, apo në institucione të tjera, si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, janë 44 (dyzetë e katër) ish-të dënuar, që janë ekzekutuar, vrarë ose kanë vdekur nga mundimi dhe sëmundjet gjatë vuajtjes së dënimit, aksidentet në punë, apo në tentativë arratisjeje.

Sipas hetimeve paraprake të grupit të punës, janë siguruar fakte të tilla, si: Personat që ekzekutoheshin, apo vdisnin gjatë vuajtjes së dënimit, varroseshin nga personeli i burgut në vende jashtë territorit të burgut, duke u pamundësuar të afërmit të tyre, në çdo rast, që të marrin trupin; vendet që kanë shërbyer si vendvarrime për të burgosurit që kanë humbur jetën në Spaç, dyshohet se gjenden pranë varrezave të fshatit Shpalë, në fshatin Gëziq, Kodër-Spaç, rreth 1 km në jug-perëndim të Burgut të Spaçit; si dhe në disa raste, ekzekutimet janë kryer në vende, ku si kriter i vetëm ishte largësia nga zonat e banuara.

Autoriteti është në pritje të miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuar ose të dyshuar". Autoriteti, si një nga autoritetet përgjegjëse, po merr masat paraprake dhe do të ndërveprojë me pushtetin vendor Mirditë, duke siguruar mbrojtjen e vendvarrimeve të identifikuar, apo dyshuara, duke siguruar në çdo rast, ruajtjen e integritetit të vendit të ngjarjes dhe mbetjeve mortore.

Autoriteti siguron publikun se, rezultatet e këtij hetimi do të bëhen transparente dhe me punën e thelluar, në bashkëpunim me institucione përgjegjëse do të bëjë ç'është e mundur që plaga e pambyllur e familjeve në kërkim të qartësimin të fatit të familjarit të tyre, vrarë pa gjyq, apo ekzekutuar në kushte jonjerëzore, të mbyllet me gjetjen e tyre dhe nderimin që u takon, pranë familjeve.

AUTORITETI SHQYRTON DOKUMENTACIONIN ARKIVOR TË KOMISIONEVE “MEZINI” DHE “BEZHANI”

Tiranë, 07.06.2023 - Pas ndryshimeve ligjore dhe interesit të lartë të publikut, për mënyrën si është kryer verifikimi i figurave nga këto komisione, Autoriteti ngriti një Grup Pune, me objekt “Identifikimin dhe njohjen e akteve juridike dhe veprimtarinë e dy institucioneve përgjegjëse, lidhur me procesin e



kontrollit të figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë në Republikën e Shqipërisë, listës me bazë të dhënash të dokumentacionit arkivor të krijuar, numrin e zyrtarëve të verifikuar prej tyre dhe rezultatin e verifikimit, procesin e grumbullimit, marrjes në administrim dhe përpunimit të fondit dhe praktikave ndërkombëtare për verifikimin e figurave”. Në përfundim, grupi ka hartuar një raport përmbljedhës, që është me miratuar me Vendim. Për shkak të informacionit që përmban, është me nivel klasifikimi.

Disa nga gjetjet e këtij raporti, përmbledhen shkurtimisht, si më poshtë:

Fondi arkivor i shqyrtuar përgjatë periudhës 1996-2001, përbëhet nga 274 dosje dhe 24.034 fletë.

Komisioni “Mezini” e ka filluar punën me kërkesat e para, në 27 mars 1996, me rastin e zgjedhjeve parlamentare. Përgjatë kohës së funksionimit, në fokus ka qenë verifikimi i figurave të organit ligjvënës, Kuvendit.

Gjithsej, në dy zgjedhjet parlamentare dhe një lokale, të viteve 1996 dhe 1997, kanë marrë pjesë 71 subjekte politike. Ndërkaq, ky komision ka marrë vendime për 4.964 kandidatë, duke dhënë konfirmim për 4.563 kandidatë dhe përjashtim nga kandidimi, të 399 kandidatëve ose 7 % e numrit total, rezultoi me probleme të pastërtisë.

Nga 399 e kandidatëve të përjashtuar nga kandidimi, 45 kanë paraqitur ankimim në Gjykatën e Kasacionit; nga këto, në 37 raste, Gjykata e Kasacionit ka lënë në fuqi vendimin e komisionit.

Në komisionin “Mezini”, grupi i punës ka identifikuar të paktën 40 raste, me vendime kontradiktore, që u përkasin subjekteve të ndryshme politike të zgjedhjeve të vitit 1996 dhe 1997. Nga këto 40 raste, 21 kandidatë rezultuan me ndalesë për të kandiduar, ndërsa 19 prej tyre u lejuan të kandidojnë edhe pse duket se figuronin me të njëjtat probleme, me pastërtinë e figurës.

Komisioni “Bezhanj” e zhvilloi veprimtarinë, prej vitit 1998 deri në fund të vitit 2001, duke shqyrtuar pastërtinë e figurës për 3.759 zyrtarë të lartë. Ky komision, ndryshe nga ai paraardhës, kishte në fokus të punës, kontrollin e figurës së funksionarëve të administratës shtetërore.

Për 278 zyrtarë ose 7% e numrit të përgjithshëm, për të cilët, rezultonte se ka të dhëna për ta, në dokumentet e ish-Sigurimit, për të paktën 104 prej tyre, pra, për 3% më pak të numrit, komisioni “Bezhanj” ka vendosur të japë certifikatën e pastërtisë së figurës, duke i konsideruar kandidatët, si persona që nuk janë në kushtet e pengesës ligjore, për të vijuar me emërimin në detyrë.

Nga analiza vihet re, se, përgjatë periudhës së funksionimit të dy komisioneve, ligji i kontrollit dhe verifikimit të figurave ka pësuar ndryshime, duke lehtësuar barrierat për ndalimin e kandidimit në Kuvend, apo Pushtet lokal, si dhe emërimin në detyra të larta shtetërore dhe institucione të pavarura, të zyrtarëve të gjetur me të dhëna.

Të gjitha vendimet e komisioneve, nuk janë shoqëruar me argumentim sipas dispozitave përkatëse të ligjit nr. 8043, por vetëm konfirmohet nëse kandidatët janë ose jo, në kushtet e ndalimit të neneve, 1 dhe 2, të ligjit.

Kështu, si rezultat i ndryshimeve ligjore, në maj të vitit 1997, që ngushtonin rrethin e pozicioneve dhe cilësive të konsideruara si kusht pengues, komisioni “Mezini” ka marrë disa vendime të kundërta me ato të një viti më parë, duke i lejuar kandidatët, të vijojnë me kandidimin ndërkohë që një vit më parë, të njëjtët kandidatë ishin në kushtet e pengesës ligjore, sipas nenit 2, të ligjit. Ndryshime ligjore vijuan edhe në janarin e vitit 1998, kohë kur komisioni “Bezhani” kishte vetëm 4 muaj që funksiononte dhe vepruan deri në dhjetor të vitit 2001, kur ligji, me vendim të Kuvendit, u abrogua.


Të dy komisionet, kanë raportuar në mënyrë periodike për gjetjet, si edhe kanë informuar institucionet kërkuese, për rezultatet e verifikimit dhe gjetjet.

Ndërkaq, Autoriteti, përgjatë viteve 2017-2022, ka verifikuar 2.399 zyrtarë lidhur me pastërtinë e figures, përpara emërimit/ngritjes në detyrë. Nga verifikimet, 77 zyrtarë ose 3.2 % e numrit total kanë rezultuar me të dhëna në emër të tyre, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

Nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të verifikuar nga Autoriteti, 55 prej tyre ishin verifikuar më parë, nga komisionet “Mezini” - “Bezhani”, kështu që për ta, Autoriteti, nuk mund të kryente verifikim, kur ishte dhënë çertifikata e pastërtisë. Por, ndër ta, në 9 raste të konstatuara përmes proceseve paralele ose 16.3% e tyre, u gjetën rastësisht, të dhëna që e lidhnin figurën e zyrtarit me strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit.

Tashmë, me rënien e mburojës ligjore, Autoriteti ushtron kompetencën edhe për ato raste, kur është dhënë çertifikata e pastërtisë së figurës, nga komisionet e mëparshme.

Por, për të disiplinuar procesin dhe në kuadër të transparencës së mëtejshme, AIDSSH përmes ndryshimeve ligjore ka propozuar detyrimin që, çdo funksionar i lartë, të plotësojë formularin e vetëdeklarimit, ndryshime që janë tanimë në kalendarin e punës së legjislatorit. Kjo, do të garantonte një shkëputje morale, të plotë, me të shkuarën.



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Adresa: Njësia administrative nr. 4, Rruga e Dibrës
Garnizoni "Skënderbej", Tiranë
<http://www.autoritetidosjeve.gov.al>